



**MBËSHTETJE KODIT CIVIL DHE TË DREJTAVE PRONËSORE
EUROPEAID/133833/C/SER/XK**

KONTRATA NR. 2014/344-574

RAPORTI FILLESTAR

GUSHT 2014

Emri i Projektit:	“Mbështetje Kodit Civil dhe të Drejtave Pronësore”
Numri i Projektit:	EuropeAid/133833/C/SER/XK
Shteti:	Kosovë

Kontraktuesi kryesorë: **Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH GIZ International Services**

Personi për kontakt:
Ms. Elena Fernandez Frontan, Project Director
Tel.: +377 45 352428 / +381 38 223 138
E-mail: elena.frontan-fernandez@giz.de

Në bashkëpunim me: **Kosovo Legal Services Company L.L.C dhe B&S Europe**

Autoriteti kontraktues: **Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë**
Kosova str. 1
10000 Prishtinë, Kosovë
P.O. Box 331

Personi për Kontakt:
Mr. Enrico VISENTIN, Rule of Law Task Manager
Tel: +381 38 5131286
E-mail: enrico.visentin@eeas.europa.eu

(Nënshkrimi)

Përfituesi: **Ministria e Drejtësisë**
Zyra e Qeverisë Nr. II
1000 Prishtinë, Kosovë

Personi për kontakt:
Ms. Selviqe Elezaj
Udhëheqëse e Divizionit për Bashkërendim të Politikave
Tel: +381 38 20018244 / +377 45 302317
E-mail: selviqe.elezaj@rks-gov.net

(Nënshkrimi)

Data e raportit: 15 August 2014
Periudha raportuese: 1 July – 15 August 2014
Autor i raportit: Dr Victor Chimienti
Udhëheqës i Ekipit &Ekspert i Ligjit të Detyrimeve
Tel: +377 45 899144
E-mail: victor.chimienti@giz.de

(Nënshkrimi)

Disclaimer

Ky raport është përgaditur nga ekipi i projektit. Përfundimet, zbulimet dhe interpretimet të shprehura në këtë dokument i takojnë vetëm autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk duhet marur si pasqirim i mendimeve dhe politikave të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Përmbajtja

0	PARATHËNIE	5
0.1	Përmbledhje.....	5
0.2	Shkurtesat	6
1	KONSPEKTI I PROJEKTIT	7
1.1	Objektiva e përgjithshme	8
1.2	Synimi dhe objektivat specifike	8
2	BACKGROUND-I DHE SHPJEGIMI I ARSYESHËM	10
2.1	Kodi Civil dhe të drejtat për pronësi.....	10
2.1.1	Situata në sektor	10
2.1.2	Nevoja për intervenim.....	11
2.1.3	Sfidat.....	12
2.1.4	Projektet e rëndësishme	12
2.1.4.1	Programi për të drejta pronësore të USAID	12
2.1.4.2	Këshilla Reformave Ligjore	13
2.1.4.3	Menaxhimi i tokes/Kadastra	13
2.1.4.4	Programi për përbarim dhe legjislacion komercial i USAID	13
3	AKTIVITETET GJATË FAZËS FILLESTARE	15
3.1	Themelimi i zyrës së projektit	15
3.2	Rekrutimi i stafit për mbështetje afatgjate dhe përzgjedhja fillestare e ER.....	15
3.3	Takimi iniciues me Autoritetin Kontraktues	15
3.4	Vendosja e kontakteve me Palën Përfituese dhe palët tjera me interes	15
3.5	Bashkërendimi i donatorëve dhe strategjia e përgjithshme	16
3.6	Definimi i shtrirjes së projektit në Kodin Civil dhe sektorët për të drejtat pronësore.....	18
3.7	Zhvillimi i Raportit fillestar	18
4	KUPTIMI I KUSHTEVE TË MARRËVESHJES (KM)	19
4.1	Definimi i konceptit të Kodit Civil.....	19
4.2	Interpretimi i shtrirjes së aktiviteteve lidhur me të drejtat e pronës	19
4.3	Supozime dhe rreziqe	20
5	PLANIFIKIM I PROJEKTIT	23
5.1	Planifikim për tërë zgjatjen e projektit KCDP	23
5.1.1	Qasja.....	23
5.1.2	Struktura e punës së projektit	23
5.1.3	Planifikimi i Projektit sipas komponentave.....	25
5.2	Planifikimi për periudhën e ardhëshme raportuese	26
5.3	Përgaditjet e implementimit	27
6	PROJEKT MENAXHMENTI	29
6.1	Roli dhe pozita e Përfituesëve dhe Palëve me interes	29
6.2	Struktura e menaxhmentit	30
6.3	Këshilli Drejtues i Projektit	30
7	EKSPERTËT JOKYÇË	32
8	ORARI I RAPORTIMIT	33
9	LISTA E SHTOJCAVE	34

0 PARATHËNIE

0.1 Përmbledhje

Ky raport përshkruan rezultatin e Fazës Fillestare të projektit “**Mbështetje Kodit Civil dhe të drejtave pronësore**” (këtej e tutje, projekti “KCDP”) dhe *përgjigjet* kërkesave të Autoriteteve Kontraktuese të vlerësojnë situatën pasi të njejtat kanë pësuar ndryshime që nga hartimi i Kushteve të Marëveshjes (KM).

Konspekti i projektit është prezantuar në Kapitullin 1, përederisa background-i dhe shpjegimi i arsyeshëm i KCDP-së diskutohen në Kapitullin 2. Kapitulli 3 prezanton aktivitetet që kryhen në fazën fillestare. Në këtë kontekst, strategjia kyçe ishte bashkërendimi me donatorët dhe USAID në veçanti për sa takon sektorit të drejtave pronësore (kapitulli 3.4, f.18).

Strategjia e implementimit e përshkruar në projekt propozim është përshtatur me situatën e tanishme, me kërkesat e Autoriteteve kontraktuese dhe me nevojat e Përfituesit. Disa çështje kyçe u diskutuan, qartësuan dhe pajtuan gjatë Fazës Fillestare. Çështjet të cilat janë ngusht të lidhura me nevojën për definim të konceptit të Kodit Civil dhe gjërësinë e aktiviteteve të projektit në sektorin e të drejtave pronësore, janë analizuar hollësisht në Kapitullin 4.

Aktivitetet dhe rezultatet e parapara me KM ngelin ashtu si janë përshkruar dhe planifikuar. Sidoqoftë, me qëllim që të sigurojmë rezultate të arritshme dhe qëndrueshme me reference Komponentës C.9 të MK, ky raport fillestarë e ka zvogëluar perimetrin e aktiviteteve të Projektit, të cilat do të kishin qenë shumë të gjëra dhe do të bënin rezultatet të paarritshme, si është sqaruar edhe në Kapitullin 4.2, f.20.

Plani i Punës së projektit (për tërë kohëzgjatjen e projektit) është prezentuar në Kapitullin 5. Është strukturuar në tre Komponenta.

- Komponenta A –Bashkërendimi i donatorëve dhe strategjia e përgjithshme. Aktivitetet e kësaj komponente janë strukturuar të konstatojnë bashkërendim me donatorë dhe projekte tjera me qëllim të optimizimit të rezultateve të projektit KDCP
- Komponenta B – Kodi Civil
- C – Të drejtat pronësore.

Përederisa aktivitetet e Komponentës B dhe C kanë për qëllim të tejkalojnë problemet e qenësishme të kompleksitetit të legjislativës ekzistuese në sferën e Kodit Civil dhe të Drejtave Pronësore, aktivitetet e Komponentës A do të ndihmojnë në shmangjen e tepricave dhe do të përdorë efekte sinergjike përmes kordinimitit dhe bashkëpunimit me donatorët dhe projektet tjera dhe, andaj, do të optimizohen rezultatet e këtij projekti.

Kapitulli i njejtë përmban një pjesë për planifikim të periudhës së ardhëshme raportuese dhe një pjesë për përgaditjet për implementim të detyrave.

Në Kapitullin 6 prezentojmë:

- Roli dhe pozita dhe roli i Përfituesit dhe Pjesëmarrësve/Aktorëve të Rëndësishëm, dhe
- Struktura e menaxhmentit të Projektit KCDP

Kapitulli 7, dhe 8 përshfijnë profilet e ekspertëve Jokyç dhe orarin raportues .
Lista e Shtojcave qëndron në Kapitullin 9.

Ekipi i Projektit njehson përkrahjen e Përfituesit dhe do të jetë falemnderues për çfarëdo lloji sugjerimesh dhe mendimesh të cilat do të kontribuojnë implimentimit të përgjithshëm e të suksesshëm të Projektit KCDR.

0.2 Shkurtesat

ABGB	Allgemeines Bürgerliches Gesetzbuch (Kodi Civil Austriak)
AZK	Alternativa për Zgjidhje të Konlikteve
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AZZB	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
BE	Bashkimi Evropian
BGB	Bürgerliches Gesetzbuch (Kodi Civil Gjerman)
BMZ	Ministira Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
DCFR	Draft Common Frame of Reference
D/p	Ditë pune
EJK	Ekspertë Jokyç
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeritit
KM	Kushtet e Marëveshtjes
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit Në Kosovës
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH
GIZ IS	GIZ International Services
QK	Qeveria e Kosovës
IPA	Instrument of Pre-Accession Assistance
MD	Ministria e Drejtësisë
MoU	Memorandum of Understanding
NSh	Ndërmarjet Shoqërore
KDP	Koordinatori për të Drejtat Pronësore
PDP	Programa për të Drejta Pronësore e
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
DPSA	Dialogu për Procesin e Stabilizim-Asocimit
SIDA	Swedish International Development Corporation Agency
UNDP	United Nations Development Program
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo
USAID	United States Agency for International Development
VNR	Vlerësim i Ndikimit të Rregullores
PLK	Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial
ZKE	Zyra e Komisionit Evropian (Kosovë)
ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
ZK	Zyra e Kryeministrit

1 KONSPEKTI I PROJEKTIT

Projekti KCDP ka për qëllim përkrahjen dhe lëvizjen përpara kah vlerësimi i përafërt i legjislativës ekzistuese në sferën e Kodit Civil dhe të Drejtës Pronësore me *Acquis* në sferën e drejtësisë; politikave të ndërmarjeve dhe ato industriale; the 'parimet e përgjithshme të së drejtës' (as referred to in the case law of the Court of Justice); dhe parimet e Këshillit të Evropës (përbërëse në KEDNJ dhe Protokollet e saj). Kjo fushë e intervenimit është e domosdoshme për kërkesat në Procesin e Stabilizim-Asocimit dhe për prioritetet politike të Kosovës për integrim në BE.

Shpjegimi i arsyeshëm qëndron në arsëyet si vijojnë:

- Situata e përgjithshme ligjore sa i përket Kodit Civil dhe të Drejtave Pronësore, dhe në veçanti mungesa e një Kodi Civil gjithpërfshirës dhe të freskuar dhe një trup në rritje me ligje të shpërndara të cilat rregullojnë sektorin e të drejtës civile dhe çështjet pronësore.
- Nevoja pasuese për të harmonizuar dhe përmirësuar ligjet ekzistuese.
- Nevoja për të siguruar pajtueshmëri me standardet ligjore evropiane me qëllim që të arrihen kërkesat e *acquis* Evropiane, dhe
- Reshtim me praktikatat më të mira Evropiane¹.

Karakterizohet si vijon:

- Legjislativa e Kodit Civil dhe të çështjeve e të drejtave pronësore është e copëtuar dhe e palidhur, buron nga periudha të ndryshme të shtetësisë. Prandaj ekziston edhe mospërputhshmëria dhe kundërshtimet në legjislacion dhe të njejtat krijojnë konflikte
- Disa nga ligjet nga e drejta civile, si që është ligji për obligime, i trashëgimisë, i punës, i pronës (ku bën pjesë edhe ai i hipotekës dhe garancës) ekzistojnë, por duhet të analizohen, rishikohen, korigjohen dhe të sillen në linjë me konceptin e përgjithshëm e të kuptueshëm të Kodit Civil.
- Implementimi i ligjeve ekzistuese është i dobët dhe praktika për zbatim të këtyre ligjeve është joadekuate

Projekti i KCDP do të zbatohet në kontekst (si dhe faza përfundimtare) të Komponentës 1 të "Kontrata Kornize për Dizajnim të Projektit në Fushën e Kodit Civil dhe të Drejtat Pronësore nën IPA 2013". Për këtë qëllim, një Raport Vlerësues është finansuar nga IPA i cili shpalon rezultatet e analizës mbi situatën momentale në fushën e legjislacionit lidhur me Kodin Civil dhe të Drejtave Pronësore, duke përfshirë aty edhe ndihmën e donatorëve dhe projekteve tjera. Raportit në fjalë (në tekstin e mëtejshëm "IPA Raport Vlerësues")

Raporti Vlerësues i IPA përmban edhe rekomandime për ndihmë të metutjeshme të IPA-s në fushën e legjislacionit lidhur me Kodin Civil dhe të drejtave pronësore, e cila ndihmë duhet fokusuar në dy etapa distinktive:

- Etapa 1 – Reforma legjislative, dhe
- Etapa 2 – Mbikqyrje të implementimit të projektit

Shtetet si Kosova, me aspiratë për t'i ju bashkangjitur Bashkimit Evropian duhet harmonizuar ligjet nacionale, rregulloret dhe procedurat me ato të BE-së, me qëllim që të bëjnë tërë strukturën ligjore të BE-së efektive përmes *akive/acquis*. Prandaj, ky projekt do të jep kontribut të madh arrijtes së këtij qëllimi.

¹ Një burim rëndësishëm i këshillës dhe informimit profesional është puna kolektive e Grupit Studiuës mbi Kodin Civil Evropian dhe Grupit Hulumtues mbi Ligjin Privat të cilët kanë prodhuar Dispozitat, definicionet, model-rregulloret e Ligjit Privat Evropian – Draft Common Frame of Reference (DCFR)". Grupime të ndryshme të modeleve si që është Lando Group's Principles of European Contract Law (PECL) dhe the Principles of European Tort Law.

1.1 Objektiva e përgjithshme

Qëllimi i përgjithshëm i KDCP-së është:

- Të përforcojë sundimin e ligjit, dhe
- Të përafrojë legjislacionin vendor të Kosovës me *standarde Evropiane* në fushën e drejtësisë dhe të drejtave pronësore.

Kjo formulë përcakton se KDCP ka për qëllim të sjell legjislativën Kosovare afër asaj Evropiane-jo afer cilave do standarde ligjore-ndërkombëtare², gjë që do të kërkojë bashkërendim dhe bashkëpunim të ngushtë me objektivat dhe donatorët e tjerë të projektit, në veçanti me Programen për te Drejta Pronësore të USAID dhe tjera projekte të ngajshme.

Përderisa KM kërkon që projekt propozimi i KDCP duhet të ndjek standardet Evropiane dhe traditat e Kodit Civil dhe regjimit të Drejtave Pronësore, KM poashtu kërkon bashkëpunim dhe bashkërendim me donator dhe projekte tjera, në veçanti me USAID i cili luan rol udhëheqës në këtë fushë në Kosovë.

1.2 Synimi dhe objektivat specifike

Sipas Kushteve të Marëveshjes objektivat specifike e KDCP-së, mund të përshkruhen si vijon:

- Të bëhet analizë gjithpërfshirëse e Kodit Civil eksistues,
- Të bëhet analizë gjithpërfshirëse e të drejtave pronësore në Kosovë dhe në bazë të asaj të fillohet procesi i përmirësimit të tërësishëm të kornizës legjislative lidhur me të drejtat pronësore.

KDCP sheh rëndësi në zhvillim të një Kodi Civil gjithpërfshirës dhe harmonizimin e tij me *Acquis communautaire* dhe me parimet tjera të BE-së, si dhe me fortësimin e të drejtave pronësore në dobi të sundimit të ligjit, zhvillimit socio-ekonomik dhe integritimit të Kosovës në BE. Parimet e Këshillit të Evropës të pasqyruara KEDNj, parimet e përgjithshme të së drejtës civile (referuar ligjit të Gjykatës së Drejtësisë)³, dhe *Acquis communautaire* do të shërbejnë si vegla për të aritur qëllimet e parapara.

Rezultatet e mëdhaja janë radhitur më poshtë në mënyrë më të detajuar dhe duhet të jenë si vijon:

- Pas analizës tërësore të problemeve ekzistuese mbi të drejtat pronësore, zhvillohet *plan i përgjithshëm* për reformë të Kodit Civil dhe të drejtave pronësore. Plani do të jep bazën për analiza të politikave⁴ dhe kornizës ligjore të Strategjisë të përgjithshme Nacionale për të Drejta Pronësore.
- Hartohet Kod Civil *gjithpërfshirës* për Kosovën.

Nga formulimi i objektivave të veçanta, puna e projektit do të strukturohet nëpër tre Komponente:

- Komponenta A – Bashkërendim mes Donatorëve dhe strategji e përgjithshme. Aktivitetet e kësaj komponente janë strukturuar të konstatojnë bashkërendim dhe bashkëpunim me donatorë dhe projekte tjera me qëllim të optimizimit të rezultateve të projektit KDCP
- Komponenta B – Kodi Civil
- Komponenta C – Të drejtat pronësore.

² Konfirmim për këtë kuptim mund të gjendet në faqen 14 të MK-së ku është paraparë , sa l përket rezultateve 1.3 dhe 2.3 që vlerësimi juridik duhet bërë për të dKodin Civil dhe të drejtat pronësorw sipas Snadardeve Evropiane dhe praktikave më të mira, në mënyrë që të identifikohen zbrayëtirat dhe mospërputhshmërite.

³ Interpretim i dispozitave të Legjislacionit të BE-së, dhe në veçanti direktivave

⁴ Dimensioni politik mund të jetë i rëndësishëm vetëm në një gjerësi të caktuar që tregon zbrazëtirën në legjislacion e cila duhet plotësuar dhe kërkon konsiderim nga opsione të ndryshme , ose nëse zgjedhja nëmës opsioneve në nivel të linjës së veprimit është e mundur në mënyrë të drejtohen rezultatet e ligjit ekzistues.

Edhe se Komponenta B dhe C në një masë të madhe janë të shpjeguara si të ngjajshme dhe në vartësi, ato nuk duhet ngratëruar (specifikat e secilës Komponentë janë elaboruar hollësisht më poshtë nën Aktivitetet e projektit). Në përgjithësi, Komponenta B duhet parë si grupazh i aktiviteteve që kanë për qëllim aritjen e kodifikimit të një kornize të integruar dhe unifikuar për të gjitha ligjet esenciale nga e drejta civile gjegjësisht Kodi Civil , kurse rezultatet kyçe të Komponentës C do të jenë hartimi i planit të përgjithshëm për reforma që jep bazën për analizë të tërë kornizës ligjore të Strategjisë së përgjithshme Kombëtare mbi të Drejtat Pronësore. Në këtë aspekt duhet përmendur që reforma e të drejtave pronësore dhe pamja e saj e saktë si e dizajnuar në planin e përgjithshëm dhe Strategjinë Kombëtare, do të varet shumë nga rezultati i vlerësimit të kryer dhe nga konsultimet me Përfituesin të bëra në bashkëpunim dhe bashkërendim me të gjithë aktorët relevant, donatorët dhe partnerët e tyre implementues. Sidoqoftë, skica finale e reformave mbi të drejta pronësore mund të del si kombinim me legjislativën e Kodit Civil (p.sh. ligj i pronës private) ose si grupazh i veçantë i ligjeve dhe/ose ndryshim ligjeve, në çështje të veçantë lidhur me sektorin e të drejtës pronësore.

Poashtu, është e nevojshme të theksohet që Komponenta C paraqet nivel të lartë të rëndësisë. Kjo është kështu nga disa shkaqe, si për shembull kompleksiteti i thellë i kornizës ligjore dhe rregulluese në Kosovë, gjegjësisht kompleks përzirjesh të ligjeve nga koha e Jugosllavise, nga koha e UMNK-ut dhe ligje Kosovare. Një shkak tjetër është natyra problematike e qenësishme e të drejtave për pronësinë në Kosovë si rezultat i ndodhive në rajon. Vështirësi të mëtutjeshme kanë lindur nga konflikti në fund të 1990 që poashtu rezultoi në zhdukje të dokumenteve, shpërngulje e regjistrin kadastror në qytete jashtë Kosovës, zhvendosje e banorëve në destinacione të panjohura dhe mbizotërim i transferëve jozyrtare të pronave para dhe pas konfliktit. Veç kësaj, gjatë konfliktit të 1990, pronat ishin të zhdukura, njerëzit të zhvendosur, kurse vendbanimet dhe tokat ishin okupuar dhe re-okupuar ilegalisht. Ndërtimet joligjore poashtu ishin sunduese menjëherë pas konfliktit.

Raporti Vlerësues IPA, Raporti i Progresit (2013), EC Feasibility Study (2012) si dhe dokumente tjera që tregojnë nevojën që nëmes tjerash duhet fokusuar edhe në çështjet si vijojnë:

- Kornizë e copëtuar e rregulloreve e të drejtave për pronësinë dhe kodit civil
- Zbrazëtira dhe mospërpuethshmëri në ligje kyçe të të drejtave për pronësinë dhe në legjislativën e Kodit Civil
- Jurisdiksion i mjegullt dhe i mbivendosur mes autoriteteve qeveritare në fushën e të drejtave pronësore dhe Kodit Civil.
- Skeme e kuptueshme e rregullores së pronësisë dhe të drejtave pronësore duke përfshirë këtu një regjim të pastër të kadastrës dhe të drejtës së regjistrimit të pronës.
- Konflikt i traditave ligjore si rezultat i zhvillimeve historike në Kodin Civil dhe fushat lidhur me të drejtat e pronës
- Terminologji e qëndrueshme e Kodit Civil dhe legjislativës së të drejtave të pronës
- Probleme lidhur me llojet speciale të pronës (kryesisht pronat shoqërore) si që është privatizimi dhe problemet lidhur me te (p.sh. 99-year Qiramarje/dhenije) ose mungesë e skemës kompenzuese për banesat prone shoqërore dhe problemet lidhur me procedurat si që janë konfiskimi dhe dëmshpërblimi.
- Mbrojtje e dobët gjyqësore/ligjore dhe zbatim të drejtave të pronës
- Ndërtime të paligjeshme

Është shfaqur edhe një çështje specifike nga problemet lidhur me mundësinë e gruas për të ushtruar të drejtat pronësore në praktikë, posaçërisht të drejtat e trashëgimisë. Me ligj, të drejtat e pronësore të gruas janë të mbrojtura po jo edhe në fakt. Me këtë problem mund të meremi nën Komponentën B të KDCP-së si pjesë e procesit të kodifikimit të Kodit Civil. Por, edhe Programi i të Drejtave Pronësore të USAID ka për qëllim adresimin e sfidave lidhur me mbrojtjen e të drejtave të gruas për trashëgimi , posedim prone dhe shfrytëzim të së njejtës (shih Objektivën 3: “Rritje e të Drejtave të Gruas për Përdorim të Pronës në Praktikë”). Për këtë do të nevojitet bashkëpunim të ngushtë mes dy projekteve në mënyrë që të mënjanohen dyfishëzime dhe mospërpuethshmëri dhe të sigurohet që kërkesat e KM-së janë plotësuar.

2 BACKGROUND-I DHE SHPJEGIMI I ARSYESHËM

2.1 Kodi Civil dhe të drejtat për pronësi

2.1.1 Situata në sektor

Implementimi i projektit KCDP do të ndikohet nga fakti që 1: Pavarësia e Kosovës është arritur vetëm gjashtë vite më parë pas lufte, dhune dhe shkatërrimi dhe 2: situata specifike në fushën e legjislacionit të dhe të drejtave pronësore e cila karakterizohet si e copëtuar, me mospasje të koherencës dhe me mungesë të rrjedhës së logjikshme për implementim të ligjeve dhe rregulloreve.

Deri para deklaratës së pavarësisë së Kosovës në 2008⁵, janë bërë tentime për vendosje të një vazhdueshmërie ligjore që nga Mbretëria e Sërbisë në atë të Jugosllavisë, në Republikën Federale të Jugosllavisë, në Republikën e Sërbisë dhe Malit të Zi, në Republikën e Sërbisë. Gjatë periudhës me pak se 100 vjeçe, pesë regjime të ndryshme ligjore kanë ndjekur njëri tjetrin duke dhënë një lloj baje për të menduarit ligjorë, gjë që është ruajtur në një mënyrë ose në tjetër dhe ka formuar një skelet për traditë ligjore

Mes viteve 1999 dhe 2008 kur when Kosova shpalli pavarësinë. Misioni Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK, ka lëshuar një sërë ligjesh dhe rregullativash që kanë drejtuar çështjet pronësore, ka themeluar institucione të pavarura për privatizim të Ndërmarrjeve shoqërore dhe për të adresuar kërkesa lidhur me prona private, si që është Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) Poashtu, UNMIK ka krijuar Dhomën Speciale në kuadër të Gjyqit Suprem të meret me ankesat lidhur me pronën që vijnë nga këta institucione të pavarura.

Në 2008, Qeveria e Kosovës hartoi Kushtetutën e re dhe lëshoi ligje dhe rregullativa që adresojnë të drejtat pronësore. Duhet cekur që Kushtetuta e Kosovës përmban dispozita speciale për të drejta pronësore dhe ato mund të shërbejnë si pikënisje e kodifikimit të ligjit për pronësinë.

Origjina e të drejtës civile në Kosovë përmban gjurmë nga e drejta civile ish Jugosllave. Historikisht, e drejta civile Jugosllave ka qenë e ndikuar nga Kodi Civil Austriak (KCA), nga sistemi i ligjeve të përmbledhura Gjermane (KCGj) dhe nga Kodi Civil zviceran. Kodi Napoleonit poashtu ndikoi pjesë të sitemit të së drejtës civile Jugosllave (p.sh. ligji i detyrimeve).

Që nga pavarësia, Kosova ka filluar të hartojë Kodin Civil me asistencën e projekteve ndërkombëtare. Hartimi përmban pesë libra:

- Pjesa e përgjithshme.
- Detyrimet.
- Prona.
- Familja
- Trashëgimia.

Kjo ka ndjekur tadtitën e Evropës Qëndrore por përpjekjet janë lenë pasdore e janë ëvendësuar me ligje të ndara. Këto ligje janë:

⁵ Ky emërtim është pa paragjykime për pozitën dhe statusin dhe është në pajtim me UNSCR 1244 dhe me GjND mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

- Ligji për marrëdhënjet e detyrimeve Nr. 04/L-077⁶,
- Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore Nr.0 3/L-154,
- Ligji për Familjen Nr. 2004/32,
- Ligji për Trashëgiminë Nr. 2004/26,
- Ligji i Punës Nr. 03/L-212

Si shtesë këtyre ligjeve parimore, janë miratuar ligje të shumta të posaçme (p.sh. disa ligje që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore transferuese dhe regjistrim, dhe kadastra) Një analizë e thellë e ligjeve dhe rregulloreve në këtë fushë do të jetë etapa fillestare e këtij projekti.

Problemi më i madh në këtë zgjidhje është mungesa e lidhjes logjike dhe harmonizimit ndërmjet tyre që mund të zgjidhet me pajtim dhe kodifikim që poashtu përmban edhe parime të përgjithshme.

2.1.2 Nevoja për intervenim

Për dallim nga shumë shtete Evropiane, Kosova, për shkak të zhvillimeve historike, gjatë rrugëtimit është ngarkuar duke shtuar ligje një nga një ashtu si që është paraqitur nevoja ose/dhe si është sugjeruar nga administratorët ndërkombëtarë, donatorë, dhe nga projekte të ndryshme. Si rezultat, kemi një mozaik copash (të brendshme dhe jashtme) të legjislativës të jokompletuar, e cila duhet të ndriqet sipas kërkesave të standardeve dhe legjislacionit të BE-së.

Nga fakti që pas Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, UNMIK dhe OJQ të ndryshme kanë hyrë në vend për të përkrahur ndërtimin institucional dhe ligjorë, dhe ashtu, ligje dhe koncepte të ndryshme ligjore janë propozuar dhe implementuar. Si rezultat i kësaj, pamja ligjore e Kodit Civil, në aspekt të konceptit ligjorë dhe traditës, në një shkallë të lartë, është e copëzuar dhe heterogjene.

Ende më e pakënaqur është situata me sistemin e të drejtave pronësore e cila situatë në një raport të OSBE-së në 2009 sqarohet si “e komplikuar dhe siç duket e padepërtueshme”. USAID në 2011 e konfirmoi atë vështrim duke thënë që “puna e tanishme e institucioneve nuk është dizajnuar për t’i përballuar sfidat e çështjeve pronësore në mënyrë efikase dhe të frytshme”. Problem specifik është ai i të drejtave të gruas në fushën e të drejtave pronësore. Çështje tjera të rëndësishme në sektorin e të drejtave pronësore janë edhe prona publike, shoqërore, privatizimi, regjistrimi i pronës, statusi i tokës për ndërtim, qasja në të dhënat e kadastrës, etj.

Më tutje, që nga fillimi nuk është njoftuar asnjë parim ligjor drejtues. Propozimet për ligje dhe zgjidhjet për problemet janë bazuar edhe në të drejtën civile evropiane por edhe në ligjin anglo-sakson. Kjo gjë ka krijuar struktura ligjore konfliktuoze, mendime dhe zgjidhje të cilat duhet të rrezgjidhen përmes hartimit të të Kodit të ri Civil dhe legjislacionit të drejtave pronësore.

Nevoja për intervenim më përkrahje përmes këtij projekti fuqizohet edhe nga:

- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nën Neni 1, Protokollin 1, “gëzimi paqësor i pasurisë”,
- Standarti i sigurisë ligjore i njohur nga ligji i BE-së dhe KEDNJ⁷,

⁶ Ky ligj është hartuar nën asistencë të GIZ dhe përfshinë rregulat esenciale për detyrime dhe kontrata.

⁷ Siguria juridike është një cilësi themelore e rendit ligjor dhe kërkesë për sundimin e ligjit . Koncepti i sigurisë ligjore është vendosur në të gjitha sistemet ligjore evropiane dhe ka qenë e njohur si një nga parimet e përgjithshme të ligjit të BE-së nga ana e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë që nga viti 1960 .Si një Parim i përgjithshëm në të drejtën e BE-së , kjo do të thotë se ligji duhet të jetë i sigurt, i qartë dhe preciz , dhe implikimet e saj ligjore të jenë të parashikueshme . Standardi i sigurisë ligjore është përcaktuar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut , e cila " kërkon që ligji , qoftë me shkrim apo i pashkruar , të jetë i mjaft preciz për të lejuar qytetar – nëse duhet , me këshillimin e duhur - të parashikojë , në një shkallë të arsyeshme të rrethanave , pasojat e veprimit që mund të vijnë si rezultat.

- Zhvillimi ekonomik që është mëse i nevojshëm parë situatën momentale në vend- zhvillim të mëtutjeshëm të qëndrueshëm, dhe
- Drejtësi shoqërore dhe paanësi.

Kodifikimi i pjesës esenciale të së drejtës civile në Kodin Civil jep një 'çati' nën të cilën më pas, ligje civile tjera shpesh, sistematikisht do të mund të organizohen dhe sinkronizohen. Kodi Civil do të jep bazë për kornizën ligjore të regjimit pronësorë në qendër të së cilës qëndrojnë të drejtat e pronësisë me të gjitha pasojat e besnikërisë ndaj të drejtave njerëzore dhe zhvillimit socio-ekonomik të Kosovës.

2.1.3 Sfidat

Kushtet e Marëveshjes përmendin tre fushat e mëdhaja problematike:

- Kompleksiteti i kornizës ligjore të Kosovës.
- Mungesa e vahdeshmërisë ligjore për shkak të zhvillimeve historike.
- Ngjajshmëria e qëllimeve të këtij projekti me Programin për të drejta pronësore të USAID , gjë që kërkon bashkërendim të saktë dhe të hollësishëm pa mos e humbur qëllimin e definuar të këtij projekti.

Poashtu, duhet cekur që projektet e kaluara, si dhe projektet në rrjedha dhe ato të planifikuara, mund të kenë prerë qëllimet, gjë e cila mund të mjegullojë rrugën kah qëllimi i pastër, i hollësishëm dhe i unifikuar.

Një çështje tjetër brenguese është se Koordinatorin për të Drejtat Pronësore në Zyrën e Kryeministrit që është edhe një ndër partnerët kryesorë për implementim të KCDR-së, për momentin ballafaqohet me mungesë të stafit, buxhetit adekuat, gjë që mund të sjell efikasitet jokënaqës gjatë bashkëpunimit me Partnerët.

2.1.4 Projektet e rëndësishme

Si që është cekur me poshtë në Komponentën A, është me rëndësi të vlerësohet përvoja dhe qëllimet e projekteve të kaluara, atyre në rjedhë dhe të planifikuara me qëllim që të shfrytëohen efektet sinergjike dhe të ju iket tepricave dhe konflikteve, dhe të organizohet bashkërendim dhe bashkëpunim me donatorët dhe projektet tjera.

Lista e projekteve më të rëndësishme (për bashkërendim dhe bashkëpunim) të kaluara, në rrjedhë dhe të planifikuara, janë radhitur në Shtojcën 1. Mes projekteve të radhitura aty, më të rëndësishmet për KCDP janë Programi për të drejta pronësore të USAID ,projekti i BMZ për përkrahje të menaxhimit të tokave dhe kadastrës, projekt i GIZ që ende është duke u implementuar, Projekti për Reforma Ligjore i finansuar nga BMZ implementuar nga GIZ dhe ende në rrjedha, dhe Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial i USAID, etj.

Gjithashtu, të rëndësishëm janë projekte të cilat kanë përkrahur zhvillimin e Kodit Civil (GIZ 2003-2004, të cilat për fat të keq nuk janë pranuar nga shkaqe jashtë zbatimit të vet projektit).

2.1.4.1 Programi për të drejta pronësore të USAID

Qëllimi i përgjithshëm i Programit për të drejta pronësore të USAID (PDP) është të përmirësojë regjimin e të drejtave pronësore në Kosovë, të forcojë sundimin e ligjit dhe të zmadhojë rritjen ekonomike dhe investimet. PDP do të arrijë qëlliminduke u fokusuar në katër objektiva: (1) bashkërendim më të mirë dhe rënditje të prioriteteve në fushën e të drejtave pronësore në bashkëpunim të ngushtë me partnerët (2) procese të përmirësuara ghyqësore në rastet e kërkesave pronësore; (3) rritja e mundësive të gruas të ushtrij të drejtat e saja pronësore në praktikë; dhe (4) qasje më të madhe në informata dhe kuptim të drejtave pronësore.

Arritja e të katër objektivave do të kërkojë bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me sektorin e duhur publik dhe privat të Kosovës me homologë dhe Përfitues, si dhe me Donatorë. Deklarata e punës përsërit që në implementimin e këtyre objektivave, PDP do të koordinoj nga së afërmi dhe do të koordinoj e këshillojë të gjithë donatorët e rëndësishëm dhe partnerët e tyre implementues, në veçanti Komisionin Evropin në Kosovë dhe Bankën Botërore.

Për më tepër mbi aktivitetet koordinuese gjatë fazës implementuese, ju lutemi shihni Kapitullin 3.

2.1.4.2 Këshilla Reformave Ligjore

“Këshilla Reformave Ligjore” (2009-2014) është projekt i finansuar nga BMZ implementuar nga GIZ ka pasur për qëllim përmirësimin e zhvillimit të hartim-ligjeve për procedura legjislative në linjë me Kushtetutën e Kosovës dhe me kornizën ligjore të BE-së. Projekti ka përkrahur procesin e hartimit ligjor, përfshirë edhe hartimin/përmirësimin e ligjeve dhe rregulloreve të administratës publike për të rritur efektshmërinë gjyqësore me theks në Analizën e Ndikimit të Rregullores (ANR). Me tutje, projekti ka qenë i kyçur edhe në hartimin e legjislacionit të ri duke hartuar, mbledhur dhe komentuar ligje nga e drejta civile si përgaditje për zhvillim të ardhshëm të Kodit Civil të përgjithshëm në linjë me *acquis* e BE-së. Projekti përmban edhe përkrahjen e Grupit punonjës të MD-së për të drejtat pronësore dhe përkrahje të studimit Socio-ligjorë dhe Vështrimin mbi të Drejtat e Gruas në tokë dhe pasuri të patundshme. Si Grupi punonjës ashtu edhe studimi do të përdoren nga KCDP-ja si burim dhe do të meren parasysh gjatë implementimit të aktiviteteve.

2.1.4.3 Menaxhimi i tokës/Kadastra

BMZ poashtu financon projektin ‘Menaxhimi i tokës/Kadastra’ (2008-2015), implementuar nga GIZ. Objektiva e këtij projekti është të forcoj sigurinë ligjore të pronësisë së tokës dhe banimit duke përmirësuar proceset dhe kualitetin e të dhënave në linjë me praktikën më të mira të BE-së. Midis shërbimeve të ndryshme deri më tani. Projekti ka bërë edhe: përkrahje në reformën e kornizës ligjore duke përfshirë edhe realizimin e konferencës së nivelit të lartë të quajtur “Roli i Kadastrës dhe titujt pronësorë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik”; ka organizuar puntori mbi “Legjislacioni në fuqi që i përket të drejtave pronësore dhe barasisë gjinore në Kosovë” në pilot zyrat e kadastrës të komunave; ka hartuar “Studim raste të mirëmbajtjes së kadastrës”; dhe përmes trajnimeve ka përkrahur 4 pilot zyra komunale të kadastrës (Prishtinë, Mitrovicë, Gracanica dhe Hani i Elezit). Detyra e fazës së tanishme është që të bëjë analizë të manireve punonjëse dhe proceseve në pilot komunitet me qëllim që të ndrojnë dhe rihartojnë rregullativën në tërë territorin e shtetit të jetë në përputhje me *acquis* e BE-së, ashtu që proceset punonjëse të dhënat në regjistrat e tokës dhe kadastrat përmirësohen dhe korespondojnë me standardet aplikative të BE-së.

2.1.4.4 Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial i USAID

Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial i USAID, është program 3 vjeçar i cili ka filluar në Maj 2013 dhe është i planifikuar të zgjat deri në Prill, 2016. PLK shërben për përmirësim të sundimit të ligjit dhe të krijojë rreth më të mirë biznesi për zhvillim ekonomik dhe investime. Si i tillë, programi është ndërtuar me dy qëllime strategjike: 1) asistencë institucioneve Kosovare të përmirësojnë zbatimin rasteve nga e drejta civile dhe dramatikisht të zvogëlojnë rastet e mbetura pa zbatuar në gjqet kosovare dhe 2) asistencë Kosovës në zhvillimin dhe forcimin e kornizës së legjislacionit të kontratës dhe komercial dhe sistemeve, përfshirë edhe ndërmjetësimin.

- 1) Zbatim i përmirësuar i vendimeve dhe zvogëlim i zbrastirave

PLK programi përkrah Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe gjyqet të përmirësojnë menaxhmentin e rasteve dhe të risin efikasitetin në zbatimin e veprave. Programi punon ngushtë me stafin gjyqësorë për të bërë theksim më të madh ybatimin e rasteve kundër llogarive debitore bankare si kundërshtim të konfiskimit dhe ankandit të pronës së tundshme. Momentalsiht, sistemi gjyqësorë ka më tepër se 200,000 vendime të pazbatuara. PLK programi dhe Këshillin gjyqësor kanë venduar pikësynim eliminimin e punës së pabërë deri më 2016. Programi përkrah MD-në të implementojë procedurat w ybatim ligjit përfshirë edhe futjen në përdorim të Sistemit të agjencive private zbatuese.

2) Forcim dhe përmbarim i kornizës legjislative të kontratës dhe asaj komerciale dhe sistemeve përfshirë edhe mekanizmat për ZAK

PLK programi punon ngushtë me komunitetin e biznesit Kosovar për të përmirësuar dijeninë dhe kuptimin e rëndësisë për përdorim të kontaktave të shkruara dhe futje në përdorim të mekanizmave për zgjidhje alternative të konflikteve si që janë ndërmjetësimi dhe gjykim. Programi ka prodhuar disa formulare standard për kontrata me sqarime dhe komente ligjore. Programi poashtu realizon seri të takimeve në forme të tryeave të rrumbullakëta me komunitetin e biznesit nëpër tërë Kosovën.

PLK programi i mbështet Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në hartim të ligjit të falimentimit. Poashtu, Programi e finalizon hartimin e gjashtë rregulloreve për implementim të ligjit të ri të detyrimeve..

3 AKTIVITETET GJATË FAZËS FILLESTARE

Gjatë Fazës Fillestare janë ndërmarrë këto aktivitete:

3.1 Themelimi i zyrës së projektit

Akomodimi me zyrë për ekipin e projektit është bërë i mundshëm fill pas datës së mobilizimit të projektit me qëllim të sigurohet funksionimi i mirë që nga fillimi i Projektit KCDP. Gjithashtu janë siguruar edhe lidhjet telefonike dhe kompjuterike.

Lokacioni i zyrës:

Rr. Nënë Tereza Nr. 34/3, kati 2-të, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 223 138

3.2 Rekrutimi i stafit për mbështetje afatgjate dhe përzgjedhja fillestare e ER

Udhëheqës zyre (2 vite), Zv/Drejtor Projekti (2 vite), Përkthyes-Interpretues/Asistent administrativ (2 vite).

Stafi për afat të shkurtër, ndërkombëtar dhe vendor/rajonal, do të punësohet sipas nevojave. Gjatë Fazës fillestare iu është bërë një vështrim i parë profileve të ekspertëve afatshkurtë dhe kontributeve të ngjashme, dhe procesi i rekrutimit ka filluar (kryesisht për Aktivitetet B1/B2 dhe C1/C2). Pritet që për të përballuar nevojat e projektit gjatë periudhës së afërm të implementimit, duhet të jenë bërë emërimet e raundit të parë të ekspertëve Jokyç si për Kodin Civil dhe Komponentët e të Drejtave brenda muajit të 2-të të funksionimit të projektit.

3.3 Takimi iniciues me Autoritetin Kontraktues

Një takim iniciues midis Kontraktuesit dhe Zyrrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë (ZBE) është mbajtur më 2 Korrik 2014 në premiset e ZBE-së. Takimet/kontaktet e rregullta tashmë janë vendosur ndërmejt Udhëheqësit të Ekipit në emër të Kontraktuesit (menaxhmenti i projektit) dhe Udhëheqësit të Detyrave në emër të ZBE-së. Nuk janë parashikuar raporte të ndara lidhur me këtë, por nëse paraqiten çështje të rëndësishme për tu diskutuar, do të hartohen dokumente përkatëse. Do të mbahet një ngjarje iniciuese publike me pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë në periudhën e afërm të pas-inicimit të projektit, gjegjësisht më 9 Tetor 2014.

3.4 Vendosja e kontakteve me Palën Përfituese dhe palët tjera me interes

Konsulenti ka organizuar disa takime deri më sot me personelin e lartë nga Ministria e Drejtësisë (MeD). Me kërkesë nga Projekti KCDP, MD ka emëruar dy persona nga stafi si Pika Kontakiti për qëllim të zbatimit të projektit: (1) Znj. Selvije Elezaj, Udhëheqëse e Sektorit për Bashkërendim të Politikave, dhe (2) Znj. Anita Çavdarbasha, Zyrtare Ligjore nga Departamenti Ligjor i MD-së, të cilët do të shërbejnë si pika të para të kontaktit në komunikimin me ekipin e projektit.

Janë mbajtur edhe takime tjera me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Zyrën e Kryeministrit, KPA, PAK, OSCE, GIZ, si dhe me aktorë tjerë kyç dhe projekte përkatëse nga donatorë të jashtëm (noterë, banka, etj.), për të prezantuar Projektin KCDP dhe për të diskutuar lidhur me mundësitë e ndryshme të bashkëpunimit. Një listë e të gjitha këtyre takimeve është përfshirë në Shtojcën 2.

3.5 Bashkëndimi i donatorëve dhe strategjia e përgjithshme

Me KM nga Projekti KCDP kërkohet që nga afër të koordinohet me të gjithë donatorët relevant dhe me partnerët e tyre për zbatim, si dhe në veçanti me Programin mbi të Drejtat e Pronës (PDP) e USAID-it.

Qëllimi i përgjithshëm i Programit të USAID për të Drejtat e Pronës (PDP) është të përmirësojë regjimin e të drejtave të pronës në Kosovë, të forcojë sundimin e ligjit, dhe të ris zhvillimin ekonomik dhe investimet. PDP do ta arrijë këtë qëllim duke u fokusuar në katër objektiva: (1) bashkëndimi dhe vendosja më e mirë e prioriteteve të politikave në fushën e të drejtave të pronës në bashkëpunim të afërm me palët relevante; (2) procese të përmirësuara gjyqësore që kanë të bëjnë me kërkesat pronësore; (3) mundësi të avancuara për femrat për të ushtruar të drejtat e tyre pronësore në praktikë; dhe (4) qasje më të madhe në informata dhe kuptimin e të drejtave pronësore.

Një fushë ku bashkëndimi dhe bashkëpunimi me PDP mund të jetë i nevojshëm është Objektiv 1: Bashkëndimi më i Mirë dhe Prioritetet në Politika. Ky Objektiv adreson (1) sfidat e zhvillimit që lidhen me nevojat për një vizion dhe strategji të koordinuar për regjimin mbi të drejtat pronësore në Kosovë; (2) mungesa e një strukture institucionale përkatëse për të udhëhequr dhe zbatuar reformat të cilat janë dakorduar; dhe (3) nevoja për legjislacion primar dhe sekondar të harmonizuar dhe me cilësi të lartë.

Në këtë aspekt, PDP pritet që të kontrollojë kualitetin e legjislacionit dhe të identifikojë fushat që kanë nevojë për shqyrtim, forcim ose harmonizim. Sidoqoftë, si që e ka specifikuar në kushtet e veta të marëveshjes PDP patjetër të koordinohet nga afër me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBE) për të identifikuar boshllëqet dhe mospërputhjet në legjislacionin e drejtave pronësore, duke u fokusuar në ato ligje që janë vendimtare për zbatimin e programit, të drejtat e gruas dhe pakicave

Një fushë tjetër e përshtatshme për bashkëpunim të afërm është Objektiv 3: Të drejta të avancuara të femrave për të shfrytëzuar pronën në praktikë. Nën këtë Objektivë hasen dyfishime të mundshme ndërmjet dy projekteve. PDP ka mar për detyrë përmirësimin e ligjeve lidhur me të drejtat e gruas për yotësi prone dhe trashëgimi. Sipas Planit të Punës, PDP është e përkushtuar të “kryejë një analizë të hollësishme të boshllëqeve dhe mangësive legjislative që kanë të bëjnë me të drejtat e femrave. Kjo mundësisht mund të ndikojë në Projektin KCDP si në Kodin Civil, ashtu edhe në komponentët e të drejtave pronësore.

Gjithashtu vlen të përmendet Objektiv 4: “Komunikimi i Përmirësuar, Qasja në Informata dhe Kuptimi i të Drejtave Pronësore”, ku PDP pritet të identifikojë mangësitë dhe të rekomandojë zgjidhje që të përmirësojë dhe udhëzojë procesin që ka të bëjë me transaksionet e pronave, emërtimet e pronësisë dhe qasjen në informata dhe shërbime. Në Planin Punues të PDP, ky objektivi është adresuar kryesisht në nivel Komunal. PDP do të adresojë mungesën e proceseve të biznesit që janë kredibile dhe efikase për të siguruar që gjykatat dhe qytetarët të kenë qasje të gatshme në dokumentet dhe shërbimet të nevojshme për tu evidentuar dhe më pas për të bërë transaksionin e të drejtave pronësore. Ekziston një theks i veçantë mbi nevojën që gjykatat dhe Komunat të kenë qasje të gatshme në informatat dhe transaksionet mbi pronën, gjë që është pjesë e një problemi më të gjerë që ka të bëjë me regjistrat e kadastrit, dhe përfshin praktikantë të tjerë ligjor, sikur edhe noterë). Qasja në regjistrat e kadastrit në MCO është në të vërtetë me interes të madh për Projektin KCDP.

Bazuar në këtë më sipër, një takim i parë njohjeje është mbajtur më 3 Korrik 2014 me Udhëheqësin Vendor të USAID-it dhe me shefin e Palës së PDP. Udhëheqësi i Ekipit dhe EK 2 morrën pjesë në takim në emër të Projektit KCDP. Udhëheqësi i Detyrës nga ZBE gjithashtu morri pjesë në takim. Qëllimi dhe objektivat përkatës – pjesërisht të dyfishuara, veçanërisht në fushën e të drejtave pronësore – nga dy projektet janë diskutuar hollësisht. Çështjet lidhur me bashkëndimin dhe bashkëpunimin gjithashtu janë adresuar paraprakisht.

Më 23 Korrik 2014, është organizuar takimi i dytë me PDP për të diskutuar më tej lidhur me bashkërendimin dhe bashkëpunimin ndërmjet dy projekteve. i gjithë ekipi i ekspertëve ekspertë kyç të PDP i është prezantuar ekipit të projektit. Udhëheqësi i Ekipit dhe EK 2 ka marrë pjesë në takim në emër të Projektit KCDP. Gjatë këtij takimi, është rënë dakord që Udhëheqësi i Ekipit i Projektit KCDP dhe Shefi i Palës së PDP të shkëmbejnë planet e punës përkatëse dhe të kthehen me komente, nëse kanë. Dy ekipet e projektit gjithashtu kanë rënë dakord të takohen sërish pasi që planet e punës përkatëse të jenë shkëmbyer dhe rishikuar. PDP gjithashtu ka ofruar të ndihmojë Projektin KCDP gjatë hartimit të legjislacionit lidhur me pronën në Kosovë. Gjatë takimit, është përsëritur që Projekti KCDP duhet të udhëheq me hartimin/ndryshimin e legjislacionit primar.

Si rezultat i kontakteve të mëtejme midis dy udhëheqësve respektiv të projekteve, më 29 Korrik 2014 është rënë dakord për një mirëkuptim të përbashkët që një Program i Përbashkët nuk do të kishte qenë praktik, ndërsa një përkushtim i përbashkët do të ishte shumë i arsyeshëm. Besohet se një Plan Pune i plotë i zakonshëm nuk do të ishte i këshillueshëm e as i zbatueshëm për shkak të ndërlíkueshmërisë së të dy projekteve, dhe veçanërisht për Projektin KCDP, i cili udhëheq paralelisht dy komponentë tematik shumë të gjerë, i vetmi me dyfishime të pjesërishme të objektivave prej dy projekteve (Meqenëse Projekti KCDP nuk merret vetëm me të drejtat pronësore, por gjithashtu edhe me Kodin Civil, ndërsa PDP vendos një theks të veçantë në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me pronën nëpër komuna, të cilat janë përtej shtrirjes së Projektit KCDP), si dhe kornizën kohore të ndryshme (2 vite vetëm për KCDP, ndërsa PDP do të zgjasë katër vite).

Udhëheqësi i Ekipit i KCDP dhe Shefi i Palës së PDP dhe ekipet e tyre u takuan sërish më 4 Gusht 2014 që të arrijnë një përkushtim të përbashkët të pranueshëm për të dyja palët. Në përgjithësi, është arritur pajtueshmëri që PDP poashtu do të asistojë Projektin KCDP në hartimin e legjislacionit të zbatueshëm në sektorin e pronës.

Sidoqoftë, Projekti KCDP do të ndajë me PDP përgjegjësinë e identifikimit të boshllëqeve dhe mangësive në legjislacionin që kanë të bëjnë me pronën dhe të propozojë zgjidhje praktike se si të adresohen këto boshllëqe dhe mangësi. Si që është paraparë nga dokumentet e saja planifikuese, PDP do të fokusohet në ligje/çështje të cilat prekin të drejtat e femrave dhe/ose bashkësive minoritare.

Takim i ardhëshëm u organizua më 21 Gusht për të definuar më mirë kushtet e bashkëpunimit dhe bashkërendimit në mes dy projekteve dhe për të përmbyllur të gjitha bisedat. Ky takim u mbajt në prezencën e udhëheqësve të projekteve si dhe përfaqësues të USAID-it dhe ZBE-së. Gjatë takimit u arrijt pajtim që mënyra më e mirë për të mënjanuar dyfishëzime, zbrazëtira dhe mospërpuetshmëri, si dhe të preventohen konflikte, të stimulohen efektet sinergjike, të bëhen plotësime dhe përfundimisht, të optimizohen rezultatet e të dy projekteve, është nënshkrimi i një Memorandumi të Marëveshjes(MM) në mes dy projekteve.

Hartim MM u diskutua nga të dy palët më 26 Gusht. Hartm MM është në proces të finalizimit dhe nënshkrimit nga të dy palët. Memorandumi i Marëveshjes do të jetë pjesë e Raportit Fillestarë nën Shtojcën 9. MM do të ndihmojë sa më shumë që mundet arrijten e marrëveshjes së përbashkët mbi mënyrat e reformimit të sektorit të drejtave pronësore. Në përmbledhje MM përmban:

